



**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,**

Bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 14, paragrafi 2, nënparagrafi 2.16, dhe Dispozitat e Nenit 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr.03/L-185);
- Dispozitat e Nenit 24, paragrafi 5 të Ligjit për Energjinë elektrike (Ligji Nr. 03/L-201);
- Kërkesën e Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (KOSTT Sh.A) të datës 14.02.2013 për shqyrtim dhe aprovim të dokumentit “Dizajni i Tregut të Energjisë Elektrike në Kosovë”,

**në seancën e mbajtur me datë 01 mars 2013, nxori këtë:**

## **VENDIM**

### **I. APROVOHET “Dizajni i Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës”.**

#### **Arsyetim**

- Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 14.02.2013 ka pranuar kërkesën për aprovim të versionit final të dokumentit “Dizajni i Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës” të KOSTT SH.A. Dokumenti ka kaluar në disa faza dhe ka qenë në diskutim publik për një kohë të gjatë.
- Procesi ka filluar që nga viti 2010, dhe janë mbajtur shumë takime. Në fillim është zhvilluar një koncept shkresë (concept paper) si dokument orientues për hartimin e Dizajnit të Tregut, i cili është vlerësuar si i pranueshëm për krijimin e dokumentit final të Dizajnit të Tregut. Dokumenti është prezantuar para Komisionit Evropian në Bruksel, i cili e ka përkrah.
- Gjatë procesit të hartimit të Dizajnit të Tregut kanë qenë të involvuar akterët relevant të sektorit të energjisë përfshirë edhe konsulencën për privatizim të aktivitetit të Distribucionit dhe Furnizimit të energjisë dhe ata të projektit “Kosova e RE”. Janë mbajtur takime dhe janë pranuar komente edhe nga përfaqësues të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë në Vjenë.
- ZRRE ka qenë e kyçur gjatë tërë kohës së hartimit të dokumentit dhe ka dhënë komentet e veta si drejtpërdrejt po ashtu edhe përmes konsulencës, në takime, dhe në formë të shkruar.
- KOSTT ka dërguar në ZRRE dokumentin për aprovim për herë të parë me 16 gusht 2011. Pas komentimeve dhe ndryshimeve shtesë, duke përfshirë edhe harmonizimin me kërkesat ligjore sipas ligjeve të energjisë të modifikuara në fund të vitit 2010, KOSTT e ka dërguar dokumentin prapë me 16 korrik 2012. Meqenëse kishte paqartësi dhe nevojë për



intervenime shtesë sidomos në disa çështje të ngritura nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë në Vjenë, dokumenti ka vazhduar të komentohet dhe ndryshohet, duke marrë formën finale në fillim të vitit 2013.

- Pas dorëzimit nga KOSTT të versionit final me datë 14.02.2013, ZRRE ka vlerësuar se ky dokument, i cili është i rëndësishëm së veçantë, i përmbush kriteret për aprovim, dhe duke marrë parasysh dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

**II.** Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.

**III.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së, ku do të publikohet edhe Dizajni i Tregut.

**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

#### **Bordi i ZRRE-së**

---

Enver Halimi, kryesues

---

Përparim Kabashi, anëtar

---

Blerim Koci, anëtar

---

Merita Kostari, anëtare

---

Krenar Bujupi, anëtar